



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Hyrje në Teoritë e Komunikimit

Ngarkesa: 4 kredite, 40 orë mesimore, 25 leksione+15 seminare;

Viti / Semestri : Viti II /semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: “Bachelor në Gjuhë Frënge”

Kodi i etikës: Kodi i etikës UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Kjo lëndë u drejtohet studentëve të viti të dytë dhe synon t’i njohë studentët me zhvillimet më të rëndësishme, me konceptet dhe nocionet themelore të teorive kryesore të studiuara nga shkencat e komunikimit.

Objektivat specifike lëndore:

Kjo lëndë synon të paraqesë tërësinë e teorive të komunikimit duke ndjekur idenë e kalimit nga logjika e transmetimit te logjika e marrëdhënies dhe e pjesëmarrjes. Lënda zhvillon një paraqitje të përgjithshme të teorive të komunikimit si dhe të qasjeve ndërpersonale dhe ndërvepruese dhe kërkon të zhvillojë te studentët mendimin kritik në lidhje me dukuritë e studiuara nga shkencat e komunikimit si dhe t’u japë elemente të analizës së situatave komunikuese.

Rezultatet e të nxënit:

Në fund të këtij kursi studenti do të zotërojë njohuri mbi teoritë dhe konceptet baze në komunikim. Falë njohurive të marra, studenti do të mund të identifikojë dhe karakterizojë rrymat kryesore qëstudiojnë komunikimin. Gjithashtu, studenti do të jetë i aftë të identifikojë dhe shpjegojë dukuri që lidhen me komunikimin dhe situatat komunikuese duke u bazuar në paradigmat e komunikimit dhe duke përdorur në mënyrën e duhur terminologjinë përkatëse.